



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 128 prot.

Kamëz, më 10.11.2021

V E N D I M

Nr. 101 Datë 10 / 11 2021
PËR

**PËRCAKTIMIN E VLERAVE PËR PËRFITUESIT E GRANTIT TË
RIKONSTRUKSIONIT, BANESAT E TË CILËVE JANË KLASIFIKUAR NGA
AKTEKSPERTIZAT E THELLUARA TË INSTITUTIT TË NDËRTIMIT ME NIVEL
DËMESH DS4"**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më 10.11.2021 në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 , pasi mori në shqyrtim **Projekt –Vendim Nr.92 Datë 10.11.2021** në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nën-pika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54, shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, vendimit nr. 5, Datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, të ndryshuar, Vendimit Nr. 887, Datë 24.12.2019, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përsheptuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillim/ndërtimit, në rastet e fatkeqësive natyrore”, Udhëzimit Nr. 3, Datë 28.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”, Vendimin e Këshillit Bashkiak Kamëz Nr.21, Datë 19.02.2021, “Për përcaktimin e vlerave për përfituesit e grantit të rindërtimit, për banesat e të cilëve janë klasifikuar nga akt-ekspertizat e thelluara të Institutit të Ndërtimit me nivel dëmsh për shembje”, **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I :

1. Përcaktimin e vlerave për përfituesit e grantit të rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar nga akt-ekspertizat e thelluara të Insitutit të Ndërtimit me nivel dëmi DS4.
2. Përfitojnë vlerën e plotë të rikonstruksionit sipas preventivit të paraqitur, individët ose familjet shtëpitë individuale ose banesat e të cilëve janë klasifikuar nga akt-ekspertizat e thelluara të Insitutit të Ndërtimit me nivel dëmi DS4, por në çdo rast jo më shumë se 70 përqind të vlerës

Adresa: Bulevardi "Nënë Tereza", Nr. 492, Kamëz Tel: +355 47 200 177 E-mail: keshilli.bashkiak@kamza.gov.al, web: www.kamza.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

së rindërtimit miratuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak Kamëz Nr.21, Datë 19.02.2021, “Për përcaktimin e vlerave për përfituesit e grantit të rindërtimit, për banesat e të cilëve janë klasifikuar nga akt ekspertizat e thelluara të Institutit të Ndërtimit me nivel dëmsh për shembje”, prej:

- a. 2.100.000 (dy milionë e njëqind mijë) lekë për banesat 1+1;
 - b. 2.500.000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë për banesat 2+1;
 - c. 2.800.000 (dy milionë e tetëqind mijë) lekë për banesat 3+1 ose më shumë.
3. Shuma e grantit të rikonstruksionit shpërndahet në dy këste: kësti i parë, në masën 60 % të vlerës do të kalojë në llogarinë e Postës Shqiptare ose në llogarinë e subjektit përfitues pranë bankave të nivelit të dytë, pas depozitimit të projektit të rikonstruksionit ose listës së punimeve të riparimit dhe preventivit të punimeve që kërkohen të financohen, hartuar nga projektues të licensuar dhe e konfirmuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Kësti i dytë, diferenca e mbetur nga shuma e grantit të rikonstruksionit, pas verifikimit nga struktura përkatëse e mbikqyrjes së zbatimit të kontratës së grantit të rikonstruksionit, pasi subjekti përfitues ka përfunduar 60% të punimeve në objektin e dëmtuar.
4. Në rast se pas dorëzimit të projektit model të rikonstruksionit apo listës së punimeve të riparimit dhe preventivit të punimeve për grantin e rikonstruksionit, konstatohet se vlera e përgjithshme e tyre është më e madhe se vlera e përlllogaritur sipas pikës 2 të këtij vendimi, përfituesit i akordohet vlera që rezulton nga zbatimi i këtij të fundit.
5. Komisioni i posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e subjekteve përfituese nga programet e procesit të rindërtimit, në përmbushje të detyrës për propozimin e përfituesve dhe vlerave përkatëse të rikonstruksionit, merr si referencë kufijtë minimalë dhe maksimalë të shumave të grantit, të përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi.
6. Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit ndjekin procedurat e përshpejtuara për shqyrtimin dhe miratimin e dokumentit për leje ndërtimi, sipas parashikimeve të vendimit Nr. 887, Datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

7. Këshilli Bashkiak ngarkon për zbatimin e këtij vendimi, Drejtorinë e Rindërtimit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit, Drejtorinë e Përgjithshme të Punëve Publike, Drejtorinë e Çështjeve Ligjore, Liçensave dhe Kadastës, Drejtorinë e Emergjencave Civile dhe Strehimit, Drejtorinë e Financave dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit.
8. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

Kryetar Këshilli
Hysen Koldashi

